

THIRRJE PËR APLIKIM

**GRANTE HULUMTUESE
PËR STUDENTËT E
FAKULTETIT FILOZOFIK TË
UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

Çështjet sociale dhe personat LGBTI+



Numri i granteve të vogla hulumtuese për studentë: **Katër (4) grante**

LIDHUR ME PROJEKTIN

Detaje mbi skemën e granteve të vogla hulumtuese për studentë:

Përmes kësaj thirrjeje, ftohen studentët/et e Fakultetit Filozofik në kuadër të Universitetit të Prishtinës, shtetas/e të Republikës së Kosovës për të aplikuar në skemën e granteve të vogla hulumtuese prej 570 eurove. Kjo thirrje hapet me qëllim të rritjes dhe zhvillimit të hulumtimit mes studentëve/eve që janë të interesuar/a në fushën e çështjeve LGBTI+. Në kuadër të këtij aktiviteti do të ndahen katër grante hulumtuese për student/e të Universitetit të Prishtinës, një grup nga 2 -3 persona.

Secili përfitues/e duhet që projektin e tij/saj hulumtues ta përfundojë brenda periudhës së definuar sipas tabelës në fund të thirrjes, duke iu përmbajtur buxhetit prej 570 eurove për grup.

Llojet e aktiviteteve hulumtuese:

Temat, në kontekstin e Kosovës, që inkurajohen të hulumtohen dhe në të cilat nuk keni nevojë të kufizoheni, janë:

- Historia, të Drejtat dhe Përfaqësimi i Komuniteteve LGBTI+ në Kosovë
- Hapësirat Shoqërore, Siguria dhe Dukshmëria e Komuniteteve LGBTI+ në Kosovë
- Mirëqenia, Marrëdhëniet dhe Ndërgjegjësimi Shoqëror i Komuniteteve LGBTI+ në Kosovë

Si të aplikoni?

Për të aplikuar, së bashku me dokumentet e listuara më poshtë, ju duhet të dorëzoni një projekt propozim të hulumtimit me 500 -800 fjalë, duke respektuar standardet e shkrimit akademik, ku përshkruani arsyen për temën e zgjedhur dhe synimin. Projekti hulumtues, kur të finalizohet, duhet që të jetë 3000 - 5000 fjalë dhe të mos dallojë në përmbajtje nga projekt propozimi me të cilin është aplikuar fillimisht.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Dëshmia që jeni student/e i/e Universitetit të Prishtinës, që nxirret nga SEMS (pa vulë)
- Curriculum Vitae

Dërgoni dokumentet e mësipërme në info@cel-ks.org me subjekt “Aplikim për grante hulumtuese”.

SKEMA E VOGËL PËR GRANTE HULUMTUESE

Hapja e thirrjes dhe publikimi në kanalet digjitale	18 gusht 2025
Afati i fundit për aplikim	20 shtator 2025
Informimi mbi të përzgjedhurit/përzgjedhurat	24 shtator 2025
Dhënia e granteve të vogla hulumtuese përfituesve	TBC
Afati i fundit për dorëzim të punimeve hulumtuese	TBC
Publikimi i hulumtimeve	TBC